



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.09/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj G.A, tani Gjyqtar në Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala Nj.H, pas vlerësimit të kërkesës-ankesës së parashtruar nga pala Nj.H dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit G.A, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 18.08.2023, merre këtë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.08.08.2023, e regjistruar me numër të lëndës **AD.GJTHM.nr.09/2023**, e parashtruar nga pala Nj.H nga Mitrovice rr.”...”, kundër Gjyqtarit G.A, e **PA BAZUAR**.

A r s y e t i m

Në cilësinë e autoritetit kompetent te Gjykatës Themelore në Mitrovicë ne rrethanat aktual, me dt.08.08.2023, kemi pranuar ankesën nga pala Nj.H me vendbanim në Mitrovicë rr. “...”, e cila ankese fillimisht i është drejtuar Këshillit Gjyqësor te Kosovës, ndaj gjyqtari G.A, i cili ka qene gjyqtarë pranë Gjykatës Themelore Mitrovice Departamenti i Përgjithshëm, ndërsa tani i njëjti është Gjyqtar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Pala Nj.H në ankesë thekson shqetësimet e tij lidhur me vendosjen e çështjes penale duke e përshkruar rrjedhjen e ngjarjes duke i përshkruar veprimet e tij në raport me palën e dëmtuar, duke shtuar se gjyqtari G.A ka bere shkelje ligjore duke nxjerr aktgjykimin pa e ftuar në seance gjyqesore.

Autoriteti kompetent në rastin konkret ka marrë veprime procedurale pas pranimit të ankesës, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj subjektit të hetimit-gjyqtarit i cili ka dhënë deklaratë me shkrim lidhur me ankesën e palës Nj.H, ku i njëjti ka shpreh vërejtje në lidhje me dënimin e shqiptuar sipas aktgjykimit me urdhër ndëshkimor te dënimit me gjobe, duke shtuar se Prokuroria e Shtetit ka ngritur aktakuzën PPII.nr.420/22 të dt.29.09.2022, ndaj të pandehurit Nj.H për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-es, Prokuroria në aktakuzë ka propozuar nga gjykata që të lëshoj urdhër ndëshkimor te dënimit me gjobe pa e mbajte seance gjyqesore.

Gjyqtari i çështjes pas shqyrtimit të lëndës dhe propozimit te parashtruar nga ana e Prokurorise e bazuar në dispozitën e nenit 495 të KPP, pa mbajtur seancën dhe pa prezencën e palëve dhe duke pas për bazë dispozitat ligjore ka lëshuar urdhër ndëshkimor duke i shqiptuar dënim me gjobe te pandehurit ne shumë prej 300€ dhe shpenzimet procedurale.

Autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësi disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror janë të pa qëndrueshme, nuk kemi asnjë

dyshim të qëndrueshëm për veprimet procedurale në raport me subjektin e hetimit duke marrë për bazë përgjigjen e marrë nga gjyqtari ndaj të cilit është ngritur procedura disiplinore, i cili në mënyrë përmbajtjesore dhe ligjore i ka shpjeguar veprimet e ndërmarra, gjyqtari i çështje pas shqyrtimit të lëndës ka konstatuar se ka prova të mjaftueshme me të cilin ka aprovuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit i cili ka propozuar dhënien e Urdhrit ndëshkimorë të dënimit me gjobe dhe mbi këto rrethana gjyqtari ka marrë Aktgjykim P.nr.598/2022, dt.24.10.2022, aktgjykim i cili i dërguar te pandehurit Nj.H, i cili sipas fletedërgesës se Gjykatës te dërguar përmes Postes se Kosovës, i njëjti Aktgjykimin e ka pranuar me dt.02.11.2022.

Ne aktgjykim sipas udhëzimit juridik, pala kundër këtij aktgjykimi ka te drejte kundërshtimi ne afat prej 8 ditësh pas pranimit te aktgjykimit, pala respektivisht i pandehuri Nj.H sipas Aktgjykimit nuk ka parashtruar kundërshtim ne afatin ligjor dhe aktgjykimi është i plotfuqishëm qe nga dt.14.11.2022, i njëjti me dt.30.11.2022, ka bere edhe pagesën e dënimit me gjobe, andaj çështja e vendosjes lidhur me lëndën i përket gjyqtarit të çështjes i cili vendimin e ka mbeshtetur ne baza ligjore, pakënaqësitë e palëve te marrja e vendimit, nuk mund të konsiderohet edhe shkelje disiplinoren ne ketë rast pala e ka pasur te drejtën ligjore te parashtrimi te kundërshtimit, nëse do te parashtrohej kundërshtim gjyqtari i çështjes do ti ftonte palët e procedurës ne seance gjyqësore me qellim te vërtetimit te plote te gjendjes faktike dhe nga shkresat e lendes nuk rrjedh se kemi te bëjmë me shkelje ligjore, duke e përjashtuar edhe përgjegjësinë disiplinore ne rastin konkret.

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinorë te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullore per Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
AD.GJTHM.nr.09/2023, dt.18.08.2023

Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit Nj.H**
- 3. Gjyqtarit G.A**